REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PKR.nr.170/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË–Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtarjaVioleta Namani – kryetare e trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesional Shpresa Sahit, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.F. për shkak të veprës penale Dhënia e Ryshfetit nga neni 429 par.1 i KPRK-së,sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të RëndaPP/I.nr.2K/2019 e datë: 22.02.2019, me Marrëveshjetpër pranimin e fajësisë te datësPP/I.nr.2K/2019, dt 22.02.2019, pas mbajtjes së seancës fillestareme dt.01.04.2019, në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Arian Gashi, të akuzuarit D.F., av.A.T. me dt.02.04.2019, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T GJ Y K I M

Kundër të akuzuarit:
1.D.F., nga i ati M. e ëma M., e gjinisë K., data e lindjes..., në P. rr. ”E” nr..., i martuar, baba i ... fëmijëve, punëtor –sh. në kompaninë për t. e u. “P.T”, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

ËSHTË FAJTOR

Sepse:
Me datë 05.01.2019, rreth orës 12:00, gjatë procedurave të kalimit në pikën kufitare në Merdarë, si ndihmës i vozitësit të autobusit në Kompaninë për transportin e udhetareve "P.T", në mënyrë të drejtë për drejtë i kishte ofruar dhuratë personit zyrtarë- policit kufitar të Republikës së Kosovës, dhe atë shumën e të hollave prej 10 euro të cilat i kishte vendosur në librezën e qarkullimit dhe gjersa polici kufitar gjatë kontrollit i kishte kërkuar sqarim nëse këto të holla i kishte harruar i njëjti i ishte përgjigjur “nuk janë harruar por janë për një kafe”në atë mënyrëqë personi zyrtar të veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare ku me c’rast të hollat (bankënota 10 Euro me nr. Serik NA 4238194987) i kishin konfiskuar, ndërsa i njëjti ishte arrestuar nga policia e Kosovës,

- me këtë kanë kryer veprën penale Dhënia e Ryshfetit nga neni 429 par.1 i KPRK-së.

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 4, 41, 43, 45, 73, 74, 76 dhe neni 429 par.1 të KPRK-sësi dhe nenit 359, 365, 366, 450 të KPPRK, te akuzuarin e:

GJYKON

Të akuzuarit D.F., i shqipton DËNIM ME GJOBËnë shumë prej **700 (shtatëqind)euro,** i cili dënim do të ekzekutohet pas 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, Gjykata ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke ua llogaritur 1 (një) ditë burgim, me 20 Euro të gjobës.

Të akuzuarit D.F. i konfiskohen të hollat (bankënota 10 Euro me nr. Serik NA 4238194987), e sekuestruar nga policia e Kosovës,

Detyrohet i akuzuarit që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësorë, shumënprej 50 (pesëdhjetë) Euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP/I.nr.2K/2019 e datë: 22.02.2019, kundër të akuzuarit D.F. për shkak të veprës penale Dhënia e Ryshfetit nga neni 429 par.1 iKPRK -ës.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, me dt.01.04.2019, në të cilën seancë është aprovuar marrëveshja për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të mbrojtësit të të akuzuarit D.F. av.A.T. dhe prokurorit të shtetit, e nënshkruar edhe nga i akuzuari D.F. av.A.T. dhe kryeprokurori i shtetit.

Meqë gjykata e ka pranuar marrëveshjet për pranimin e fajësisë pasi që është bindur paraprakisht se i akuzuari D.F. marrëveshjet për pranimin e fajësisë e ka nënshkruar pasi që e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të kryerjes së veprës penale, pranim është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimit të mjaftueshëm dhe në prezencën e mbrojtësve, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet marrëveshjet e lidhur në mes të mbrojtësit të të akuzuarit D.F. av.A.T. dhe prokurorit të shtetit, për pranimin e fajësisë për kryerjen e e veprës penale ashtu siçështë akuzuar nga organi i akuzës, dhe të njëjtën e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetoj se në veprimet e të akuzuarit D.F. manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Dhënia e Ryshfetit nga neni 429 par.1 iKPRK -së, ashtu që të akuzuarine shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetitnë fund ka deklaruar se meqë i akuzuari D.F. e ka pranuar fajësinë, i ka propozuar gjykatës, qëtë njëjtit të shpallë fajtor dhe t'ua shqiptoj sanksionet penal përkatës të propozuara sinë marrëveshjet për pranimin e fajësisë, dhe si rrethana lehtësuese ta vlerësoj qëndrimin bashkëpunues të të akuzuarit që nga fillimi i kësaj procedure penale dhe arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, qët'a marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit**.**

Mbrojtësi i të akuzuarit D.F. Av.A.T. ka deklaruar se e mbështetë në tërësi marrëveshjen për pranimin e fajësisë të arritur me dt. 22.02.2019, në mes të mbrojturit tij dhe prokurorit të shtetit, pasi që pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e te mbrojturit i tij, pas konsultimeve te mjaftueshme më të si mbrojtës i tij, andaj i ka propozuar gjykatës se me qenë marrëveshja për pranimin e fajësisë është në përputhje me dispozitat e KPPRK-së , dhe e njëjta është aprovuar nga gjykata, konsiderojmë se për te dakordimi për masën dënimit për të pandehurin D.F. është arritur me dakordim të plotë me prokurorin e çështjes si dhe të pandehurin nën kushtet e cekura sin marrëveshje që i rekomandon gjykatës rreth dënimit ti caktoj një dënim me gjobë në lartësi 500-700 euro, fillimisht i potencoi disa nga rrethanat lehtësuese e që janë pranimi i fajësisë para shqyrtimit fillestar premtimin se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, pendimi i thellë dhe i sinqertë, asnjëherë më parë nuk ka qenë i ndjekur apo i përfshirë në ndonjë procedurë tjetër penale dhe është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, andaj mbi bazat e rrethanave lehtësuese gjykatës i propozojmë që lidhur me shqiptimin e dënimit me gjobë të mere parasysh edhe rrethanat socioekonomike të të mbrojturit të tij dhe atë duke i shqiptuar dënimi me gjobë minimale sipas marrëveshjes .

I akuzuari D.F. e ka mbështetë në tërësi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe mbrojtësin e tij dhe shton kërkoj nga gjykata që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të rekomanduar si në marrëveshje.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74, 75 dhe 76të KPRK-së, andaj si rrethanë veçanërisht lehtësuese e ka vlerësuar pranimin e fajësisë që në fillim të kësaj procedure penale, i shoqëruar me pendim të thellë për veprënpenale të kryer dhe premtimin se në të ardhmen nuk do ti përsëris asnjëherë këto veprime, ndërsa sirrethanalehtësuese ka vlerësuar faktin se kjo gjykatë nuk ka të dhëna se i njëjti ka qenë i gjykuar më parë, qenien e tij familjar dhe mbajtës i familjes, e në mungesë të rrethanave rënduese, të akuzuarit ishqiptojë sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i propozuar edhe në marrëveshje për pranimin e fajësisë, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprimeve inkriminuese të të akuzuaritdhe përgjegjësisë penale të të njëjtit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 41 të KPPK-së.

Vendimin për konfiskimin e të hollave-bankënota e ka marrë në bazë të nenit 69 par 1 KPRK.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, konform nenit 450par 2 nen par 2.6 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.170/19, dt.29.08.2019

Bashkëpunëtori profesional
Shpresa Sahiti

Kryetarja e trupit gjykues - gjyqtarja
Violeta Namani

KËSHILLA JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.